

VENDIM
Nr. 646, datë 1.10.2014

PËR KALIMIN E PRONËS SË PALUAJTSHME SHTETËRORE, ME EMËRTIMIN “ISH-DREJTORIA E KONVIKTEVE TË SHKOLLAVE TË MESME, TIRANË”, NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË DREJTËSISË, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 834, DATË 13.12.2006, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PJESSHME TË INVENTARIT (PJESA E PARË + PJESA E DYTË) TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE NË BASHKINË TIRANË, TË QARKUT TË TIRANËS”, SI DHE PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 1292, DATË 24.9.2008, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË DREJTËSISË TË TROJEVE DHE NDËRTESAVE TË GJYKATAVE TË RRETHEVE GJYQËSORE DHE TË GJYKATAVE TË APELIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10, 12, 13, 14 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Drejtësisë,
VENDOSI:

1. Kalimin e pronës së paluajtshme shtetërore, me emërtimin “Ish-Drejtoria e Konvikteve të Shkollave të Mesme, Tiranë”, ndodhur në zonën kadastrale 8160, me numër pasurie 2/82, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Drejtësisë, në funksion të akomodimit të Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë.

2. Heqjen e pronës së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, e cila i bashkëlidhet vendimit nr. 834, datë 13.12.2006, të Këshillit të Ministrave, dhe shtimin e kësaj prone në listën e inventarit të pronave shtetërore miratuar me vendimin nr. 1292, datë 24.9.2008, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar.

3. Ministria e Drejtësisë nuk mund ta ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen ministri i Drejtësisë dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

